



Nr. 188 Prot AIE

Dt. 11.12.2024

AiE



TRADING STANDARDS AUTHORITY

**DOGANA
CUSTOMS**

MR PROT. 26006, DT. 11.12.2024



Centre of Excellence
for Maritime Affairs

Nr. 2675 Prot



Nr. 9624/2 Prot. DPPSH

Dt. 11/12/2024

INSTAT
Republika e Shqipërisë
Instituti i Statistikave



**INSTITUTI
TRANSPORTIT**

Nr. 160/1 Prot

Dt. 11/12/2024

Nr. 2385 Prot
Dt. 11.12.24
Autoriteti Portual Durrës
DURRËS PORT AUTHORITY

Durrës më 11.12.2024



Nr. 2520 Prot
Dt. 11.12.2024
UAMA.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

MBI

“KRIJIMIN E OBSERVATORIT TE LOGJISTIKËS DETARE DHE ZINXHIRËVE

TË FURNIZIMIT – DATA LAB”

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT ALEKSANDËR MOISIU- Durrës,

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE,

INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT),

INSTITUTIT TË TRANSPORTIT,

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHTETIT,

AGJENCISË SË INOVACIONIT DHE EKSELENCËS,

DHE

AUTORITETIT PORTUAL Durrës (APD) –

QENDRËS SË EKSELENCËS PËR ÇËSHTJET DETARE (CEMA)

Sot, në Durrës, më datë 11 / Dhjetor 2024, lidhet ky Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet:

“DREJTORIA E PËRGJITHSHME DOGANAVE”, person juridik publik me seli dhe adresë: Lagjia Fushë Mëzez, autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", Tiranë, Kashar, përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm, Z. Genti GAZHELI**.

“DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLICISË SË SHETIT”, me adresë: Bulevardi Bajram Curri, Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Z. Ilir PRODA**.

“INSTITUTI I STATISTIKAVE”, person juridik publik me seli dhe adresë: Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017, përfaqësuar nga **Drejtoresha e Përgjithshme, Znj. Elsa DHULI**.

“UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU - DURRËS”, person juridik me seli dhe adresë: Lagjia 1, Rruga e Currilave, Durrës, përfaqësuar nga **Raktori. Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI**.

“INSTITUTI I TRANSPORTIT”, person juridik publik, me seli dhe adresë: Rruga e Kavajës, Ndërtesa numër 39, Hyrja 3, Apartamenti 3, Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtoresha e Përgjithshme, Znj. Lilika RADOVICKA**.

“AGJENCIA E INOVACIONIT DHE EKSELENCËS”, person juridik publik me seli dhe adresë: Bërzhitë, Tiranë, përfaqësuar nga **Drejtoresha e Përgjithshme, Znj. Enkelejda IMERAJ**.

“AUTORITETI PORTUAL DURRËS”, person juridik publik me seli dhe adresë: Lagjia nr. 1, Rruga Tregtare, Durrës, përfaqësuar nga **Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Kreshnik BAJRAKTARI**, (këtu e në vazhdim referuar si “APD”).

Baza ligjore

Ky Memorandum Mirëkuptimi hartohet në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit Nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”; Ligjit Nr. 71/2016, datë 07.07.2016 “Për kontrollin kufitar” i ndryshuar; Ligjit Nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”; Ligjit 9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual”, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 861, datë 21.11.2007 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Institutit të Transportit”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 620, datë 01.11.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Inovacionit dhe Ekselencës”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 282, datë 08.05.2024, “Për miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës”;

Duke konsideruar sa më sipër, palët kanë rënë dakord të lidhin këtë Memorandum Mirëkuptimi (në vijim “Memorandumi”), të përpiluar me kushtet si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Memorandumit

Krijimi i Observatorit të Logjistikës Detare dhe Zinxhirëve të Furnizimit. Observatori do të shërbejë si një platformë ndër-institucionale dixhitale për mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave mbi logjistikën detare dhe zinxhirët e furnizimit në Shqipëri.

Neni 2

Qëllimet e Memorandumit

Qëllimet kryesore të këtij Memorandumi Mirëkuptimi janë:

1. Agregimi i kapaciteteve në mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave për të udhëhequr proceset e vendimmarrjes mbi përmirësimin e shërbimeve të logjistikës detare dhe qëndrueshmërinë e zinxhirëve të furnizimit në Shqipëri, në funksion të krijimit të Observatorit.
2. Zhvillimi i metodave dhe metodologjive të qëndrueshme për analizën e të dhënave në fushën e logjistikës detare dhe zinxhirëve të furnizimit dhe rritjen e transparencës përmes publikimit të tyre periodik;
3. Këshillimi në përdorimin e teknologjive inovative, duke përfshirë inteligjencën artificiale, në proceset e analizës së të dhënave në fushat e transportit detar dhe atij intermodal në vend dhe në rajon;
4. Bashkëpunimi i ndërsjellët ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e kuadrit rregullator dhe operacional mbi mbarëvajtjen e proceseve logjistike dhe shërbimeve publike në fushën e logjistikës detare dhe zinxhirëve të furnizimit
5. Rritjen e kapaciteteve dhe performancës së personelit përgjegjës për analizën e të dhënave dhe statistikave në institucionet pjesëmarrëse në këtë iniciativë.

Neni 3

Roli dhe detyrat e palëve nënshkruese të Memorandumit

Palët nënshkruese të këtij Memorandumi, angazhohen në realizimin e veprimtarive me interes të ndërsjellë në fushat e mëposhtme:

1. **Universiteti Aleksandër Moisiu - Durrës** angazhohet të vendosë në dispozicion burimet njerëzore studiues e studentë, për të kontribuar në zhvillimin e metodologjive të qëndrueshme për analizën e të dhënave të mbledhura në fushën e logjistikës detare

dhe zinxhirëve të furnizimit. Për këtë qëllim UAMD përdor praktikat bashkëkohore në metodologjitë e analizës së të dhënave, udhëheq gjenerimin e punimeve përfundimtare kërkimore bazuar në rezultatet e analizës së të dhënave, dhe inkurajon stafin akademik drejt qasjeve kërkimore novatore në fushën e logjistikës detare.

2. **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** angazhohet të furnizojë me të dhëna statistikore mbi vëllimet tregtare të mallrave të importuara/exportuara/tranzit përmes porteve shqiptare, si dhe të ndihmojë në identifikimin e vendeve të origjinës dhe destinacionit, vlerës, dhe të dhëna të tjera publike dhe të dobishme për qëllimet studimore të observatorit.
3. **Instituti i Statistikave** angazhohet të kryejë analiza statistikore të të dhënave mbi logjistikën detare dhe zinxhirët e furnizimit, duke siguruar saktësi dhe besueshmëri në gjetjet statistikore, në përputhje me parimet e statistikave zyrtare. INSTAT bashkëpunon me Observatorin për të integruar njohuritë statistikore me analizën në përgjithësi, duke siguruar harmonizim midis metodologjive statistikore dhe qëllimeve të Observatorit. Për kryerjen e analizave, INSTAT-i furnizohet me të dhëna nga palët e tjera të përfshira në këtë marrëveshje. Analizat statistikore kryhen bazuar në standarde dhe metodologji të harmonizuara, duke ndjekur kriteret e cilësisë.
4. **Instituti i Transportit** angazhohet në ofrimin e të dhënave mbi sektorin e transportit dhe logjistikës intermodale. Instituti siguron furnizimin e të dhënave të detajuara dhe të përditësuara mbi infrastrukturën dhe performancën e transportit në nivel kombëtar. Instituti ofron gjithashtu mbështetje në identifikimin e sfidave dhe problematikave në sistemin e transportit dhe logjistikës, në zgjidhjen e problemeve logjistike, si dhe në dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e operacioneve logjistike.
5. **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet Departamentit për Kufirin dhe Migracionin** angazhohet të ofrojë mbështetje në pasqyrimin në kohë reale të statistikave të turizmit dhe të dhënave lidhur me vizitorët e huaj në rrugë detare, sidomos përgjatë sezonit turistik në pikat hyrëse dhe dalëse në vend.
6. **Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës** angazhohet në ofrimin e këshillave strategjike për integrimin e teknologjive inovative, përfshirë inteligjencën artificiale, në proceset e analizës së të dhënave.
7. **Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare (CEMA)** angazhohet në ofrimin e koordinimit të përgjithshëm të projektit, me qëllim përmbushjen e objektivave, mundëson komunikimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjitha palëve nënshkruese të këtij memorandumi. CEMA angazhohet në integrimin e kontributeve nga çdo palë e interesuar në një analizë gjithëpërfshirëse dhe siguron realizimin e platformës dhe të aktiviteteve sipas afateve kohore të përcaktuara dhe të bashkërenduara mes palëve.

8. **Autoriteti Portual Durrës** angazhohet të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme logjistike dhe financiare për mbarëvajtjen e platformës, siguron të dhëna të nevojshme për të analizuar operacionet portuale në kompleksin portual Durrës – Porto Romano, përpunimin e ngarkesave dhe rrugët e transportit. APD bashkëpunon me partnerët në këtë memorandum për të siguruar saktësinë e të dhënave të ofruara dhe ndan informacionet e mbledhura për të ndihmuar e përmirësuar analizën e përgjithshme lidhur me logjistikën detare dhe zinxhirët e furnizimit.
9. Për çdo formë tjetër bashkëpunimi, që kërkon mbështetjen dhe angazhimin e palëve, do të organizohen tryeza pune të përbashkëta, ku do të bashkërendohen çështjet me synim vendimmarrjen e bashkërenduar në përputhje me legjislacionin sektorial të enteve partnere.

Neni 4

Pikat e kontaktit dhe komunikimit

1. Me qëllim lehtësimin e zbatimit të këtij Memorandumi, secila nga palët përcakton një person kontakti, të cilës/it i drejtohen të gjitha komunikimet, qofshin verbale apo të shkruara, si elektronike, ashtu dhe të shtypura në letër.
2. Personat e kontaktit do të komunikohen me shkresë zyrtare pranë Qendrës së Ekselencës për Çështjet Detare (CEMA) të Autoritetit Portual Durrës brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të këtij Memorandumi.

Neni 5

Burimet e financimit

Realizimi dhe financimi i aktiviteteve të përbashkëta me qëllim promovimin e platformës dhe të publikimeve të saj, që do të vijnë në bazë të këtij Memorandumi do të mbulohen nga Autoriteti Portual Durrës.

Neni 6

Zbatimi i Memorandumit

Këtij Memorandumi do ti bashkëngjitet një plan aktivitesh të përbashkëta ndërmjet institucioneve nënshkruese, i cili do të përcaktojë planveprimet e të gjitha palëve.

Palët ngarkohen për zbatimin me korrektesë të këtij Memorandumi. Personat e ngarkuar të përcaktuar, nga secila palë si pika kontakti, janë përgjegjës për përmbushjen e detyrave respektive institucionale të përcaktuara në nenin 3, sipas përcaktimeve në plan aktivitetet e përbashkëta.

Neni 7

Kohëzgjatja e Memorandumit

1. Ky Memorandum lidhet për një afat 3 vjeçar, me të drejtë rinovimi.
2. Secila nga palët mund të tërhiqet dhe të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Memorandumin, duke njoftuar me shkrim palën tjetër, 1 (një) muaj përpara ndërprerjes.
3. Në rast se njëra nga palët tërhiqet dhe kërkon ndërprerjen në mënyrë të njëanshme të këtij Memorandumi gjatë një aktiviteti i cili është në zhvillim e sipër, kjo palë do të duhet të vijojë bashkëpunimin deri në përfundim të afatit të aktivitetit.

Neni 8

Konfidencialiteti i informacionit

1. Palët angazhohen të mos zbulojnë ose shpërndajnë informacionin konfidencial të ofruar në zbatim të këtij memorandumi ndaj një pale të tretë, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet dhe është marrë më parë autorizimi me shkrim i palës, që i përket informacioni në masën e përcaktuar nga kjo e fundit, ose sa herë kërkohet me ligj.
2. Me qëllim respektimin e të gjithë kuadrit rregullator për mbrojtjen e të dhënave, palët do të nënshkruajnë një marrëveshje specifike lidhur me tipologjinë e të dhënave që do të mund të ndajnë me njëra tjetrën për qëllime të projektit dhe eventualisht limitet e përdorimit të tyre për qëllime publikimi akademik.

Neni 9

Shtesa, ndryshime, zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët angazhohen për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Memorandum.
2. Palët mund të bëjnë shtesat e ndryshimet e nevojshme të këtij Memorandumi në çdo kohë, me pëlqimin e ndërsjellët, të paraqitur me shkrim.
3. Palët zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Dispozitat e këtij Memorandumi nuk do të çënojnë të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga kuadri ligjor sektorial që rregullon aktivitetin specifik të secilës palë, dhe as marrëveshjet e tjera të zbatuara nga palët.
2. Ky Memorandum hartohet në katërmbëdhjetë kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga dy kopje për secilën palë, të nënshkruara nga palët dhe të vulosura me vulat zyrtare të institucioneve përkatëse.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët dhe fillon menjëherë efektet e tij.

Për Universitetin Aleksandër Moisiu
Durrës
REKTOR
Prof. Dr. Shkëlqim FORTUZI

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Genti GAZHËLI

Për INSTANÇAT E SHQIPËRISE
DREJTORESHË E PËRGJITHSHME
Elsa DEJLI

Për Agjencinë e Inovacionit dhe
Ekselencës
DREJTORESHË E PËRGJITHSHME
Enkelejda IMERAJ

Për Institutin e Transportit
DREJTORESHË E PËRGJITHSHME
Lilika RADOVICKA

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së
Shtetit
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
DREJTUES MADHOR
Ilir PRODA

Për Autoritetin Portal Durrës dhe Qendrën e Ekselencës për Çështjet Detare
DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Kreshnik BAJRAKTARI